

Republika e Serbisë
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Drejtoria e Policisë

DP _____

SP/NJP _____

Data: _____

Vendi: _____

TË DREJTAT E PERSONIT TË MBAJTUR
(sipas nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale)

Policia mund përjashtimisht t'ju mbajë për arsye të mbledhjes së deklaratave apo marrjes në pyetje, më së shumti deri në 48 orë, nga koha e privimit nga liria apo koha e përgjigjes së thirrjes, për çka është e obliguar që menjëherë të njoftojë gjykatësin hetues kompetent, i cili mund të kërkojë që pa vonesë të paraqiteni para tij.

Policia është e detyruar që menjëherë, dhe jo më vonë se dy orë, t'ju dorëzojë vendimin ku ceket vepra penale për të cilën jeni të dyshuar, baza e dyshimit, data dhe koha e privimit të lirisë ose përgjigjes në thirrje dhe kohën e fillimit të mbajtjes.

Kundër vendimit për mbajtje, ju dhe avokati i juaj keni të drejtë në ankesë e cila dorëzohet menjëherë tek gjykatësi hetues, dhe i njëjti duhet të vendos mbi ankesën tuaj brenda katër orëve nga marrja e ankesës. Ankesa e paraqitur nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Menjëherë pas marrjes së vendimit për mbajtje, ju duhet të keni një avokat të cilin do ta siguron vetë, ose policia do t'ju sigurojë atë sipas detyrës zyrtare.

Seanca juaj do të shtyhet deri në ardhjen e avokatit tuaj, më së shumti deri në tetë orë, në qoftë se avokati mbrojtës nuk sigurohet deri në atë kohë, policia do t'ju lirojë ose pa vonesë do t'ju paraqes para gjykatësit kompetent hetues.

Zyrtari policor _____ data _____ në ora _____, në
hapësirat zyrtare _____ m'i ka komunikuar të drejtat e personit të mbajtur
(emri i njësisë organizative)

deri në 48 orë dhe më ka dorëzuar kopjen e formularit "të drejtat e personit të mbajtur", të cilat i kam lexuar – refuzuar ta lexojë.

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

nënshkrimi i personit të mbajtur

Vërejtje:

Në qoftë se personi nuk e ka lexuar apo ka refuzuar ta lexojë formularin, të ceket arsyeja dhe të konstatohet se personi gojarisht është udhëzuar për të gjitha të drejtat e tij ligjore:

Në qoftë se personi refuzon të nënshkruajë formularin që e ka lexuar, të ceket arsyeja:
